

# PROTOKOLL I BASHKËPUNIMIT

## NDËRMJET

### AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## DHE

### AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KROACISË<sup>1</sup>

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Kroacisë, këtu e tutje referuar si "Palët Nënshkruese",

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë, dhe

GATISHMËRINË për promovimin e bashkëpunimit më të ngushtë në trajnimin e diplomatëve,

kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

#### Neni 1

Qëllimi i Protokollit është të krijoj një bazë ligjore dhe kushte për kontakte dhe bashkëpunim të rregullt në fushat arsimore dhe shkencore në kuadër të kornizës së programeve dhe aktiviteteve të Palëve Nënshkruese.

#### Neni 2

Prioritetet e këtij bashkëpunimi janë:

- trajnimet profesionale dhe përditësimi i kualifikimit të diplomatëve në fushën e:
  - politikës së jashtme,
  - marrëdhënieve ndërkombëtare,
  - të drejtës ndërkombëtare,

- marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare,
  - shkencave politike dhe disiplinave tjera;
2. Shkëmbimi i ndërsjellë i informatave mbi çështjet arsimore, metodologjike dhe shkencore.

### **Neni 3**

Palët Nënshkruese do ta realizojnë bashkëpunimin përmes:

1. Programeve të kurseve themelore dhe të veçanta;
2. Shkëmbimit të diplomatëve, ligjëruesve, hulumtuesve dhe studentëve;
3. Hulumtimeve dhe publikimeve të përbashkëta akademike;
4. Bashkëpunimit në përgatitjen e kualifikimit, punimeve akademike dhe të disertacionit;
5. Bashkëpunimit në trajnime gjuhësore;
6. Shkëmbimit të përvojës mbi aktivitetet arsimore dhe metodologjisë së mësimdhënies
7. Shkëmbimit të burimeve arsimore, librave dhe artikujve.

### **Neni 4**

Format, kohëzgjatja dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të Palëve Nënshkruese do të zbatohen mbi bazën e reciprocitetit dhe do të dakordohen më pas ndërmjet Palëve Nënshkruese.

### **Neni 5**

Specialistët e Palëve Nënshkruese mund të marrin pjesë në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore, tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga tjetra Palë Nënshkruese. Palët Nënshkruese do të informojnë njëra-tjetrën për këto ngjarje.

Palët Nënshkruese do të promovojnë organizimin e konferencave dhe simpoziumeve të përbashkëta, zhvillimin e hulumtimit të përbashkët akademik dhe realizimin e projekteve me interes të përbashkët.

Palët Nënshkruese do të bashkëpunojnë në brenda kornizës së forumeve dhe organizatave ndërkombëtare ku ato përfaqësohen.

## **Neni 6**

Palët Nënshkruese do të mbështesin organizimin e ligjëratave dhe fjalimeve të ekspertëve nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Kroacisë, si dhe palët e treta për audiencën e akademive mbi çështje me interes të ndërsjellë.

## **Neni 7**

Mosmarrëveshjet dhe kontestet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Protokollit, do të zgjidhen ndërmjet Palëve Nënshkruese me anë të konsultimeve.

## **Neni 8**

Dispozitat e këtij Protokollit mund të ndryshohen me anë të pëlqimit të ndërsjellë me shkrim nga Palët Nënshkruese.

## **Neni 9**

Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet e vlefshme, përveç nëse njëra Palë Nënshkruese njofton palën tjetrën me shkrim për qëllim të anulimit të këtij Protokoll, tre muaj paraprakisht.

Nënshkruar në Dubrovnik, më 26 Maj 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhën Angleze.

Për Akademinë Diplomatike të  
Ministrit të Punëve të Jashtme të  
Republikës së Kosovës

**IBRAHIM GASHI**

**Zëvendës Ministër i Punëve  
të Jashtme**

Për Akademinë Diplomatike të  
Ministrit të Punëve të Jashtme  
dhe Evropiane të Republikës së  
Kroacisë

**JOSKO KLISOVIC**

**Zëvendës Ministër i Punëve  
të Jashtme dhe Evropiane**